

Ku është e mundur të bëhen varrezat konform rregullave-islame në kantonin e Cyrih-ut?

Muslimanët kanë mundësi të varrosen sipas rregullave-islame në varrezat e poshtëshënuara:

Qyteti i Cyrihut, Witikoni
(me objekt për larje të kufomës)
Witikonerstrasse 525
8053 Zürich

Telefon +41 (0)44 381 28 00
E-mail: friedhofwitikon@zuerich.ch
www.stadt-zuerich.ch → Friedhöfe (→Varrezat)

Qyteti i Cyrihut, Affoltern-it
Mundësia për varreza familjare për muslimanë për kohë të caktuar
www.stadt-zuerich.ch → Friedhöfe (→Varrezat)

Winterthur
(me objekt të improvizuar për larje të kufomës)
Am Rosenberg 2
8400 Winterthur

Telefon +41 (0)52 267 30 31
E-mail: stadtgaertneri@win.ch
www.stadtgaertneri.winterthur.ch → Rosenberg

Schwamendingen
(vetëm objekti për larje të kufomës)
Objekti për ritualet e larjes së kufomave në varrezat e Schwamendingen-it, mund të shfrytëzohet vetëm nga firma FURAT.

Cmimet:
(sipas komunave ndryshon edhe çmimi)

Varrezat e renditura
(Mirëmbajtja) në vit: rreth.40–90 CHF
Varrezat familjare
për 60 vjet: rreth. 6'500–10'000 CHF
Mirëmbajtja e varrit
(me marrëveshje) në vit: 30–100 CHF

(Në Schwamendingen mund të varrosen edhe banorët të cilët kanë jetuar jashtë vendbanimit me pagesë shtesë.)

Adresa të nevojshme të lidhjes islame dhe ndërmarrjes së funeraleve:

VIOZ
Bashkimi i organizatave islamike në Cyrih
(i drejton mëturje në shoqatat përkatëse islamike)
c/o Gjemat i bashkësisë islame të Bosnjës
Grabenstrasse 7
8952 Schlieren
Sekretar: Muris Begovic

Telefon +41 (0)44 730 80 69
E-mail: info@vioz.ch
www.vioz.ch

Ahireti AG
Varrezat islame
Turbenstrasse 27
4512 Bellach
Naim dhe Enver Fazliji

Natel +41 (0)79 532 20 17
Telefon +41 (0)32 618 46 23
E-mail: info@ahireti.ch
www.ahireti.ch (gjermanisht/anglisht/frangjisht/shqip)

FURAT International Repatriation GmbH
Ndërmarrja e funeralit- dhe i riadhesimit
Dübendorfstrasse 223
8051 Zürich

Telefon +41 (0)44 303 09 39
Natel +41 (0)79 635 99 14
E-mail: info@furat.ch
www.muslimischebestattung.ch (gjermanisht/frangjisht/anglisht)

Beerdigungsfonds
www.islamischebestattung.ch
(shqip/gjermanisht/frangjisht/turqisht)

Kantoni Cyrih
**Qendra specializuese për qështjet e integritimit/
Platforma dialogut për muslimanë**

Neumühlequai 10
Postfach
8090 Zürich
Telefon +41 (0)43 259 25 31
E-mail: integration@ji.zh.ch
Informata tjera në: www.integration.zh.ch

Nëntor 2012



Kanton Zürich

Varret konform rregullave-islame në Kantonin Cyrih (Zürich)

Informata për muslimanët

Situata në kantonin e Cyrihut

Interesimi për mundësinë për tu varrosur sipas rregullave islame sa vjen e rritet. Numri i komunave po ashtu sa vjen e rritet për t'iu përgjigjur kërkesave dhe për t'iu ofruar mundësitë për varrime sipas praktikës së rregullave islamike. Lidhjet islame së bashku me kantonin kanë miratuar kushtet e përgjithshme themelore.

Mundësia për përzgjedhjen e varrezave janë simbas infrastrukturës, mundësisë së marrëveshjes dhe interesimit si vijon (shiko grafikën):


1. Varre të veçanta apo disa varre familjare të vendosura për kohë të caktuar (me qera) në varrezat e rregullta familjare. Kjo mund të jetë një zgjidhje e përkohshme në varreza, të cilat i plotësojnë nevojat për kohë të shkurtër dhe deri më tani nuk ka egzistuar ndonjë vend i posaqëm për varre të muslimanëve.
2. Rregullimi i një fushe të varrezave të muslimanëve.
3. Rregullimi i varreve familjare në fushën e varrezave për familje të muslimanëve sipas nevojës.

Deri më tani në kantonin e Cyrihut egzistojnë shumë pak varreza për muslimanë. Muslimanët këtë problem shpeshherë e zgjidhin duke bërë pagesa intensive për qera në varrezat familjare.

[Informatat kryesore për varrimin konform- rregullave islame mund ti gjeni në këtë flyer.](#)

[Informatat e hollësishme rreth një varrimi mund ti merrni tek komuna juaj dhe tek përgjegjësit e varrezave.](#)

Mundësitë e varrimit



Rregullat themelore në kantonin e Cyrihut

Varrezat- dhe varrimi në përgjithësi janë nën mbikqyrjen e shtetit. Planifikimi, rregullimi dhe organizimi janë qështje e komunës (KVB §1, 32). Përcaktimi i rregullave-publike mbi qështjen e varrimit përbëjnë kornizën e rregullorës për varrimin në përgjithësi. Vetëm nën këtë kornizë lejohet të kryhet varrimi konform rregullave- islame- si dhe për konfesionet tjera konform – praktikës së varrimit.

Kjo kornizë përbëhet prej rregullave:

- të ligjit të shëndetësisë të kantonit të Cyrihut (GesG) (02.04.2007, §§55–57),
- të rregullores kantonale mbi qështjen e varrimit (KVB) (07.03.1963, ndryshuar u.a. 2001, 2004 dhe 2006),
- rregullores së varrezave- dhe varrimit në përgjithësi të komunës;
- Shembull: Rregullorës së qytetit të Cyrihut dhe të rregullores së çmimeve mbi qështjen e varrimit dhe rregullores së funeralit.

Vendvarrimi

Varrimi bëhet në varrezat e komunës, në të cilën së fundi ka banuar personi i vdekur dhe është pa pagesë (GesG §55 Neni.1: §56 Neni.1). Kjo vlenë gjithashtu edhe për të huajat dhe të huajt.

Kohëzgjatja e varreve

Sipas rregullores (KVB §35 neni. 2 dhe §40) kohëzgjatja e varreve zgjatë 20 vjet pa të drejtë vazhdimi. Në varrezat familjare kohëzgjatja e varreve qëndron në përgjithësi 40 ose 60 vjet; në të cilin varrimi i fundit i ka së paku 20 vjet (me perjashtim të vazhdimit të marrëveshjes).

Lidhja e muslimanëve ka lidhur një marrëveshje, që kjo kohëzgjatje të jetë së paku 20 vjet e pranuar, aq sa eshtrat, po që se është e pashmangshme (domosdoshme), me respekt dhe përkujdesje të plotë të vendoset anash ose me perjashtim të mund të riarrosset në ndonjë fushë tjetër të varrezave.

Obdukcioni

Kontrola e kufomës bëhet, po që se është e domosdoshme, në ndërkohë në shumicën e rasteve bëhet nëpërmjet kompjuterit-tomografik në vend të obduksionit. Pra hapja e kufomës është e domosdoshme vetëm atëherë, psh. kur e kërkojnë rregullat e gjykatës.

Varrimi konform-rregullave islame

Varrezat, varrimet sipas rregullave islame garantojnë, përmbajtjen e këtyre rregullave themelore të kushteve të përgjithshme:

Vendvarrezat e drejtuara kah Meka

Kufomës i takon një varr, me drejtim kah Meka (124,96°), i cili është i caktuar në një vend për varreza të muslimanëve. Në mënyrë arkitektonike është e caktuar, që i vdekuri të jetë i kthyer nga ana e djathtë e fytyrës në drejtim të Mekës.

Tek kërkesa e muslimanëve për tokë të „pastër“, lidhja e muslimanëve ka deklaruar, që vendvarrezat për muslimanë për varre të veçanta të kenë hapsirë të mjaftueshme.

Praktikimi i detyrimit të arkivolit

Në Kantonin e Cyrihut në përgjithësi sipas rregullorës, të gjitha varrimet janë të detyruara të bëhen me arkivol (KVB §10), nuk lejohet, që kufoma të varroset pa arkivol, ashtu edhe siq e parashihet religjioni islam. Me lidhjet muslimane të kantonit të Cyrihut është bërë marrëveshja, që për varrim të përdoret një dru i lehtë ose arkivol kartoni. Për mbështjelljen paraprake të kufomës me çarçaf, përgjegjës janë familjarët ose komuna e muslimanëve.

Mundësitë për lajren rituale

Larja rituale mund të bëhet në varreza, nëse egziston infrastruktura. Në varrezat, në të cilat janë të rregulluara varret për muslimanë, organizohet një objekt për larjen e kufomave. Për shfrytëzimin e këtij objekti duhet të merren parasysh rregullat poseduese.

Në qoftë se nuk egziston një objekt për larjen e kufomës, duhet të gjindet një alternativë tjetër nga bashkësia islame, nga ndërmarrja për varrime apo nga familjarët që të sqarohen me komunën përkatëse, se ku mund ta kryejnë larjen e kufomës (psh. në vendin ku qëndron kufoma, në spitale, etj.).

Vendi ku mbahet ceremonia e përmortshme

Vendi ku mbahet ceremonia e përmortshme lëshohet nga komuna për shfrytëzim sipas KVB §30. Është e përcaktuar një paisje neutrale që të mund të shfrytëzohet nga të gjithë përsونات e religjioneve të ndryshme.

Shënjat e varreve

Secili varr duhet ta ketë shenjën e vet. Si për përmbajtjen ashtu edhe për madhësinë duhet të merret leja nga udhëheqësia e varrezave. Ajo mund të jetë tabelë e thjeshtë modeste, në të cilën së paku duhet të shkruhet me shkronja latine, mbiemri, emri, data e lindjes dhe e vdekjes.

Varrezat Cyrih Witikon, qyteti Cyrih

